



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Departamenti i së Drejtës, në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Elbasanit “Aleksander Xhuvani”, shpall konkurs për pozicionin e punës 1 (një) personel akademik me kohë të plotë, i kategorisë lektor

Kandidati duhet të plotësojë këto kritere të përgjithshme e të veçanta:

Kritere të përgjithshme:

1. Kandidati duhet të mbajë të paktën gradën shkencore doktor
Grada shkencore e mbrojtur në institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jenë të njohura dhe njehsuara nga ministria përgjegjëse për arsimin
2. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet në fushën e drejtësisë, profili i së drejtës publike dhe kushtetuese.
3. Kandidati duhet të ketë mbi 2(dy) vite përvojë pune në mësimdhënie.
4. Të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të Bashkimit Europian.
5. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi të largimit nga puna.
6. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Kritere të veçanta.

1. Publikime brenda e jashtë vendit në fushën e kërkuar.
2. Preferohen kandidatë me përvojë (shkrimi, pjesëmarrjeje, drejtimi) në projektet kërkimore kombëtare, ndërkombëtare dhe europiane.
3. Preferohen kandidatë të cilët të paktën një nga ciklet e studimit e kanë kryer në universitetet e huaja.
4. CV- e vlerësuar në tërësinë e saj, përbën kriter preferencial.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve (**31.10.2022 - 9.11.2022**) nga data e shpalljes në ëëë.app.gov.al dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Formular aplikimi;
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Kopje e noterizuar e diplomave dhe të listave të notave. (Diplomat e lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë e njohur dhe njësuar nga Minsitria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- Dokumentacion shoqërues përkatës të nevojshëm original ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njehsuar me origjinalin;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës/Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për eksperiencën e punës;
- Çertifikata, kualifikime, brenda dhe jashtë vendit, të njehsuara me origjinalin;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Raport i gjendjes shëndetësore, që vërteton aftësinë për punë;
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Librezë shëndetësore

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (31.10.2022 - 9.11.2022) nga data e shpalljes në www.app.gov.al në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim për pozicionin e punës: *lektor në FE*
Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit Ekonomik. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do ti nënshtohen intervistës me gojë (11.11.2022 – 25.11.2022). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.